



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice

17 gusht 2023, Prishtinë

Thirrje publike për mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve të licencuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare

1. Ministria e Drejtësisë u bën thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të regjistruara dhe licencuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në mbështetjen e kategorive sociale dhe fuqizimin e familjes/individëve në nevojë sociale, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare.

2. OJQ-të e licencuara në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet e tyre për ofrimin e shërbimeve sociale.

3. Organizatat jo-qeveritare të licencuara mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në ofrimin dhe avancimin e shërbimeve sociale përmes zbatimit të objektivave dhe aktiviteteve si më poshtë:

- 3.1. Shërbime të rehabilitimit dhe trajtimit për personat me nevoja të veçanta, fëmijë dhe të rritur (të verbërit, të shurdhër, tetraplegjike, paraplegjike, me down sindrom, autizem, etj);
- 3.2. Shërbime rezidenciale, ditore dhe në familje për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuar;
- 3.3. Shërbime të mbrojtjes, këshillimeve psiko-sociale për fëmijë dhe të rritur.

4. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 65,000.00 euro. Për OJQ-të të cilat aplikojnë me projekte për zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve nga pika 3.1 deri 3.3, shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për një (1) projekt është 5,000.00 euro, ndërsa shuma maksimale për një (1) projekt është 20,000.00 euro.

5. Varësisht prej llojit të kategorisë së klientëve, kohëzgjatjes, shtrirjes territoriale dhe ofrimit të shërbimeve, projekti mund të financohet nga 50% deri 100% të totalit të kostove të pranueshme të shpenzimeve, por jo më shumë se sa vlera minimale dhe maksimale për një projekt individual të përcaktuar në pikën nr. 4 të kësaj thirrje dhe kriterëve të përcaktura në Udhëzuesin për Aplikantët.

6. Aplikantët dhe partnerët potencialë, për pjesën tjetër të kostove mund të sigurojnë bashkëfinancim nga donatorët dhe burimet tjera publike apo burimet vetanake.

7. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë nga data e publikimit.
8. OJQ-të mund të aplikojnë ose të jenë partner në më së shumti vetëm me një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje.
9. Periudha e zbatimit të projektit është për 5 muaj, OJQ-të mund të përfshihen më së shumti në një (1) projekt dhe të përfshihen në zbatimin e vetëm një (1) fushe prioritare.
10. Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të:
 - *Të regjistruara dhe licencuara sipas Udhëzimit Administrativ nr. 02/2020 nga MFPT/DPSF-ja;*
 - *Që janë në procedurë të licencimit por që kanë plotësuar kushtet dhe kriteret e Udhëzimit Administrativ nr.02/2020 nga MFPT/DPSF-ja dhe kanë Vendim aprovues nga Komisioni për Licencim.*
 - *Që nuk kanë qenë përfituese nga mbështetja financiare nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2023.*
11. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në ndonjërin nga llojet e fushës dhe aktivitetet të përfshira në kuadër të kësaj thirrje publike.
12. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare.
13. Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-të, duhet të paraqesin prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara.
14. Propozimet do të dorëzohen në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të Ministrisë së Drejtësisë.
15. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën; Ministrisë së Drejtësisë – Ndërtesa e Qeverisë Luan Haradinaj, pn. Ndërtesa e ish Rilindjes 10000 Prishtinë, Zyra e Arkivit në MD.
16. Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues të zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.
17. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.
18. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, tek z. Ylber Kokollari - Zyrtar për licencim në Ministrinë e Drejtësisë, duke kontaktuar përmes e-mailit në adresën; ylber.kokollari@rks-gov.net